

TAKIMI I DYTË 2023 - KOMITETI SEKTORIAL I MIKPRITJES DHE TURIZMIT

Takimi i dytë i Komitetit Sektorial të Mikpritjes dhe Turizmit u zhvillua më datë **05.07.2023**.

Mbledhja u fokusua tek: diskutimet për propozimin e hapjes së një profili të ri në “Hoteleri - Turizëm”, prezantimin e studimit mbi *“Profesionet dhe aftësitë e reja Profesionale të kërkuara në Sektorin e Turizmit dhe Hotelerisë në Shqipëri”*, diskutimet mbi këtë studim, si dhe propozimin e Metodologjisë së Studimit për Vlerësimin e nevojave.

Mbledhja u hap me prezantimin e Drejtoreshës së shkollës “Hoteleri - Turizëm”, Tiranë. Drejtoresha prezantoi anëtarët e Komitetit Sektorial me shkollën e “Hoteleri - Turizmit”, kualifikimet që ofroheshin dhe nevojën për përmirësimin e vazhdueshëm të ofertës aktuale. Drejtoresha informoi se, nga takimet me bizneset, diskutimet me bordin e shkollës dhe kërkesat e vazhdueshme të prindërve dhe nxënësve, prej kohësh kërkohej ofrimi i një kualifikimi profesional të dedikuar për *“Pastiçeri”*. Drejtoresha shpjegoi se, ky kualifikim deri në atë moment mbulohej disi si pjesë e kualifikimit: *“Kuzhinë”*, por nevojat e tregut reflektonin një mungesë të profesionistëve të kualifikuar në atë drejtim. Propozimi për ofrimin e një kualifikimi të dedikuar për: *“Pastiçeri”* u miratua nga anëtarët e Komitetit në unanimitet të plotë.

Në vijim një nga anëtarët e Komitetit Sektorial prezantoi studimin mbi *“Profesionet dhe aftësitë e reja Profesionale të kërkuara në Sektorin e Turizmit dhe Hotelerisë në Shqipëri”*, i realizuar në kuadër të projektit “Aftësi për punë”. Studimi ishte realizuar në periudhën tetor - nëntor 2022 dhe kishte përdorur si instrument intervistat gjysmë të strukturuar dhe intervistat e thelluara. Në studim ishin përfshirë 14 hotelet me performancën më të mirë, me organigramë dhe standarde të mirëfillta në hoteleri. Nga studimi rezultonte se, bizneset shqiptare në turizëm kishin vështirësi në rekrutimin e stafit të kualifikuar, sidomos në pozicionet menaxheriale të mesme dhe të përgjithshme. Pas këtij prezantimi, u propozua ofrimi i një kualifikimi të ri që të përgatiste menaxher të mesëm dhe të ishte një kualifikim i nivelit V të KSHK-së. Ky propozim u votua në unanimitet nga anëtarët e Komitetit Sektorial.

Pjesa e fundit e mbledhjes u përqëndrua në prezantimin e Metodologjisë së Studimit për Vlerësimin e nevojave. Përfaqësuesja e HDPC-së (organizatës që do bënte Studimin) informoi se, metodologjia e përzgjedhjes së kampionit do të ishte një metodologji shkencore, që të kishte përfaqësim maksimal të sektorit. Përfaqësuesja e HDPC-së informoi se, për kampionin do të merreshin vetëm kompanitë aktive, ku përfshiheshin hotelet dhe strukturat e ngjashme, akomodime për pushime, hapësirat për kampingje, restorantet, agjencitë e udhëtimit etj. dhe nuk do të përfshiheshin biznese të cilët nuk kishin të punësuar. Përfaqësuesja e HDPC-së sqaroi se, ishte menduar që të kishte tre zona për analizimin e sektorit të turizmit: Bashkia e Tiranës, zonat bregdetare dhe zonat jo bregdetare.

Në përfundim të prezantimit u dakordësua që draft-pyetësori t’iu përcillej të gjithë anëtarëve të Komitetit Sektorial për komente ose propozime.

Vendime të marra nga mbledhja:

- Të ofrohej një kualifikimi i ri profesional i dedikuar për: ***“Pastiçeri”***.
- Të ofrohej një kualifikimi i ri profesional, në nivelin V të KSHK-së, për të përgatitur menaxher të mesëm.